

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në pajtim me dispozitat e nenit 13, nenin 58 shkronja (f), nenit 62.2 dhe 65.2 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, e dt; 04 qershor 2008), të dispozitave të neneve, 77 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçilanit, 01 nr. 016-126211 të dt; 06.11.2014, Kryetari i Komunës së Gjiçilanit nxjerrë:

### V E N D I M PËR LIRIM NGA DETYRA TË DREJTORIT TË DREJTORISË PËR ADMINISTRAT TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim, z. Nazim Gagica, **LIROHET** nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.
2. Lirimi i të emëruarit nga pika 1 e këtij vendimi bëhet nga data 22.01.2018
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


#### Vendimi t'i dorëzohet:

- Z. Nazim Gagica
- Njesisë së personelit




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



## ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në pajtim me dispozitat e nenit 13, nenin 58 shkronja (f) dhe nenit 62.2 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, e dt; 04 qershor 2008), të dispozitave të neneve, 77 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 dhe 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01 nr. 016-126211 të dt; 06.11.2014, kryetari i Komunës së Gjiçanit nxjerr:

### V E N D I M

1. Me këtë vendim, **AUTORIZOHET**, z. Hajrush Ismaili i caktuar në detyra punuese:Shef i sektorit të gjendjes civile, që të Ushtrorë detyrën e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
2. I autorizuari, ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë duke filluar nga data 01.02.2018 e gjer në nxjerrjen e një vendimi tjetër dhe për punën e tij rregullisht i raporton kryetarit.
3. I autorizuari do të menaxhoj dhe udhëheqë me drejtorinë në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës dhe në pajtim me Ligjet dhe Rregulloret komunale në fuqi.
4. Të autorizuarit nga pika 1 e këtij vendimi, në bazë të nenit 89 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 1.3 të Ligjit për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-149 i **Lejohet** pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil Komunal nga data; 01.02.2018 e gjer në emërimin e Drejtorit të kësaj drejtorie, me të drejtë rikthimi në pozitën punuese para emërimit ose një pozitë ekuivalente.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
6. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi t’i dorëzohet:**


- z. Hajrush Ismaili




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri /





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE**

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

**V E N D I M  
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE  
Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve  
dhe largimi i deponive të egra në Komunën e Gjiçanit  
GI 651 17 029 521**

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Ramadan Ajvazi kryetar i komisionit
2. Edona Gashi anëtare e komisionit
3. Ahmet Aliu anëtar komisionit

**Neni 2**

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

**Neni 2.1**

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

**Neni 2.2**

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

**Neni 2.3**

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

**Neni 2.4**

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

**Neni 3**

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimit të këtij vendimi

**Neni 4**

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

Salih Kqiku

Drejtor i Departamentit të Prokurimit


**Gjilan 30/01/2018**

Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S BAŞKAN OFISI**

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kryetari i Komunës së Gjiçanit nxjerr këtë:

**VENDIM**

**PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE  
ADMINISTRATIVE LIDHUR ME TATIMIN NË PRONË**

1. Me këtë vendim, zgjedhet komisioni për shqyrtimin e ankesave administrative, lidhur me tatimin në pronë, mandat 1 (një) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një vit.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
  - 2.1 Feriz BAJRAMI - Kryesues,
  - 2.2 Burbuqe ZYMBERI - Anëtarë,
  - 2.3 Ilaz RASHITI - Anëtarë,
3. Komisioni ka për detyrë të bejë:
  - 3.1 Shqyrtimin e ankesave administrative në lidhje me tatimin në pronë me ligjin dhe UA për procedurat lidhur me ankesat e tatimit në pronën e paluajftëshme.
  - 3.2 Komisioni është i obliguar që të paraqes raport me shkrim për zyrën e Kryetarit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokolimit të tij.

Me këtë vendim njoftohen :

- Anëtarëve të Komisionit,
- Arkivi Komunal

Kryetari i Komunës


Lutfi HAZIRI







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

### PËR KOMPENSIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT TË QYTETIT TË GJILANIT

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e kompensimit për Këshillin Drejtues të Teatrit të Qytetit të Gjilanit, në lartësi prej **shtatëdhjetë euro (70)** për çdo muaj për secilin anëtar veç e veç duke filluar nga **01.01.2018 deri më 31.12.2018**.
2. Pagesa e kompensimit të përshkruar në pikën 1 do të bëhet konform Vendimit nr. 02-831 të dt. 21.01.2015 për emërimin e këshillit drejtues të teatrit të qytetit.
3. Pjesë e këtij Vendimi është raporti i punës së Këshillit Drejtues.

Anëtarët e këshilli drejtues për pagesë:

<u>Nr</u>	<u>Emri dhe mbiemri</u>
1	Sabedin Shahiqi
2	Shpresa Kurteshi
3	Avni Behluli
4	Mejreme Berisha
5	Tringa Hasani

4. Pagesa e mjeteve financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet nga kodi buxhetor për mallra e shërbime – zyra e kryetarit.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit të tij

**Vendimi i dorëzohet:**

- DBF-së
- anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit.



Kryetari i Komunës  
**Lutfi Haziri**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR KRIJIMIN E GRUPIT PUNUES PËR ORGANIZIMIN E “KONFERENCËS**  
**REGJIONALE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE”**

1. Me këtë vendim formohet grupi punues për organizimin e **“Konferencës Regjionale të Teknologjisë Informative”**
2. Grupi punues ka këtë përbërje:
  - 2.1 Gazmend Jakupi, kryetar
  - 2.2 Berat Dindari, anëtar
  - 2.3 Fatos Qerimi, anëtar
  - 2.4 Ardiana Rexhepi, anëtare
  - 2.5 Majlinda Hoxha, anëtare
3. Grupi punues ka për detyrë që të organizoj konferencën në mënyrë sa më të mirë, duke kontaktuar me zyrtarët/shefat/drejtorët etj. të fushës së TIK' -ut në institucionet Kosovare (ministrinë, agjencitë, komunat etj) për t'i njoftuar për Konferencën në fjalë dhe për t'i ftuar që të marrin pjesë me prezantimet e tyre në fushën e TIK'-ut
4. Grupi punues do t'i raportoj Kryetarit të Komunës së Gjiçanit
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

Kryetari i Komunës  
Lutfi Haziri








REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-134652 të datës 02.12.2014 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisioneve komunale të aksionarëve, kryetari i komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PAGESËN E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË**  
**FORMUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT**

1. Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.

1	<b>Xhelal Jetishi</b>	<b>200,00€</b>
2	<b>Muhadin Haziri</b>	<b>200,00€</b>
2	<b>Fadil Gashi</b>	<b>200,00€</b>

2. Kompensimi i anëtarëve të komisioneve do të bëhet për punën e kryer në takimet e komisioneve të aksionarëve për muajin DHJETOR /2017 për kompanitë PPP“ Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.
3. Kompensimi do të bëhet nga mjetet buxhetore për mallra dhe shërbime - Drejtoria për zhvillim ekonomik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa ekzekutimin e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



Vendimi i dorëzohet:

- DZHE dhe
- DBF-ja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014 si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “Tregu”, Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR ANËTARËT E KOMISIONIT**  
**KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NLP “TREGU” SHA NË GJILAN**

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare për anëtarët e Komisionit të aksionarëve për muajin **DHJETOR / 2017**, të si në vijim:

1	<b>Driton Nuhiu</b>	<b>200,00 €</b>
2	<b>Albulena Asllani</b>	<b>200,00 €</b>
2	<b>Fidan Kadriu</b>	<b>200,00 €</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>600.00 €</b>

2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi buxhetor mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomi duke u bartë në xhirlogarinë përkatëse të secilit aksionarë veç e veç.
3. Pjesë e këtij vendimi është vendimi i KK-së 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “TREGU” SHA në Gjiçan dhe procesverbalet për takimet e mbajtura të komisionit të aksionarëve.
4. Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kurse ekzekutimin e tij e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet:

- Anëtarëve
- DZHE-së,
- Arkivit.

**E APPROVUAR**  
**APPROVED**  
**ODOBRENO**




**Kryetari i Komunës**  
**Lutfi Haziri**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

---

**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S  
OFFICE/BASKAN OFISI**

---

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. **016-126211** të datës **06.11.2014**, si dhe në zbatim të nenit 9 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:

**VENDIM  
PËR**

**FORMIMIN E KOMISIONIT PËR TJETËRSIMIN DHE ASGJËSIMIN E  
INVENTARIT TË PAPËRDORSHËM TË KOMUNËS SË GJILANIT**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për tjetërsimin dhe asgjësimin e inventarit të papërdorshëm të Komunës së Gjilanit.
2. Komisioni ka këtë përbërje :
  - 2.1. Destan Maloku –kryesues
  - 2.2. Izet Kurteshi-anëtar
  - 2.3. Zoge Malaj-anëtare
  - 2.4. Eroll Jonuzi-anëtar
  - 2.5. Ermelinda Haziri -anëtare
3. Komisioni ka për detyrë të vlerësoi gjithë inventarin e papërdorshëm të Komunës së Gjilanit i cili gjendet nëpër objektet të drejtorive komunale, dhe të njëjtin t'ua transferoj organizatave tjera buxhetore të cilat kanë nevojë për atë inventar, përderisa pjesën tjetër të inventarit të papërdorshëm dhe jashtë funksionit ta asgjësojë.
4. Komisioni si në pikën 1 të këtij vendimi duhet të bashkëpunoj ngushtë me komisionin për çregjistrimin e pasurisë së komunës dhe komisionin për regjistrimin e inventarit të komunës dhe punën e vet duhet ta bazoj në Rekomandimet e këtyre komisioneve.
5. Komisioni do t'i raportoi kryetarit të Komunës së Gjilanit.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi ç'fuqizohet Vendimi për formimin e komisionit për tjetërsimin dhe asgjësimin e inventarit të papërdorshëm të Komunës së Gjilanit nr. 02-43 dt 05.01.2018.
7. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet**


- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit.



Kryetari i Komunës  
**Lutfi Haziri**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S  
OFFICE/BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. **016-126211** të datës **06.11.2014**, Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:

**VENDIM  
PËR**

**PLOTËSIMIN E PYETËSORIT PËR VETËVLËRSIMIN E KOMPONENTËVE TË  
MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësimin e pyetëtorit për vetëvlerësim e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit .
2. Komisioni ka këtë përbërje :
  - 2.1. Avdyl Jerliu, kryesues
  - 2.2. Zijadin Maliqi, anëtar
  - 2.3. Besim Azizi, anëtar
  - 2.4. Ilmi Limani, anëtar
  - 2.5. Hevzi Matoshi-anëtar
  - 2.6. Sadri Arifi, anëtar
  - 2.7. Gazmend Jakupi, anëtar
3. Komisioni ka për detyrë të ofroj informata mbi aktivitetet në Komunë duke e plotësuar pyetëtorin për vetëvlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollime me qëllim të avancimit dhe eliminimit të të metave me anë të vetëvlerësimit. Komentet duhet të shprehin gjendjen reale në Komunë .
4. Komisioni do t'i raportoi kryetarit të Komunës së Gjilanit.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi


**Vendimi i dorëzohet**

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës  
Lutfi Haziri**







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S  
OFFICE/BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL-së dhe nenit 78 dhe 107 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:

**VENDIM  
PËR  
EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIMIN E INVENTARIT NË DEPOT  
KOMUNALE**

1. Komisioni përbëhet prej gjashtë (6) anëtarëve:
  - 1.1. Berat Dindar, kryetar
  - 1.2. Fadil Xhelili, anëtar
  - 1.3. Ibrahim Jerliu, anëtar
  - 1.4. Rafet Haziri, anëtar
  - 1.5. Qahil Halili, anëtar
  - 1.6. Exhevit Rexhepi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë regjistrimin e inventarit në depot komunale.
3. Komisioni duhet të koordinojë punën me komisionin qendror për regjistrim dhe t'i paraqes raportin mbi regjistrimin.
4. Komisioni do t'i raportoi kryetarit të Komunës së Gjilanit.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:



- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Komunës



Kryetari i Komunës  
Lutfi Haziri



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjiçane  
Gilan Belediyesi

## ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të LVL dhe nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kryetari i Komunës në zbatim të nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 lidhur me nenin 4 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil nxjerr:

### V E N D I M

#### PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT AD HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË EMËRIMIT ME AFAT TË CAKTUAR - MARËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

1. Vendimi nr. 02/76 i datës 19.01.2018 për emërimin e Komisioni përzgjedhës ad hoc për zhvillimin e procedurave të emërimit me afat të caktuar për plotësimin e pozitave për kryerjen e Shërbimeve të Veçanta në bazë të Kontratave të quajtura, "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta", për pozitave e parapara sipas Shpalljes publike, nr. 02-016-3545 të datës 11.01.2018 publikuar në Web faqe Komunale dhe Tabelën e shpalljeve publike ndryshohet dhe plotësohet ashtu që në përbërje të Komisionit në rast të konfliktit të interesit për ndonjë pozitë të caktuar ku anëtarë e komisoit kanë të afër të familjes caktohet z.

#### 1. Nazmi Halili

2. Roli i kryesuesit të komisionit është sigurimi që procesi i përzgjedhjes të jetë i drejtë, objektiv i saktë dhe ta thërras anëtarin e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi vetëm për pozitën në të cilën anëtari i komisionit ka konflikt interesi me intervistuesin dhe pas përfundimit të intervistës me aplikantin e caktuar anëtari i më shumë vazhdon me intervista tjera.

3. Komisioni shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së thjeshtëzuar të rekrutimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit të tij.

Vendimi t'i dorëzohet;  
Anëtarit të komisionit  
Njësisë së personelit





Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit  
Opština Gnjilane  
Municipality of Gjilan  
Gilan Belediyesi

ZYRA E KRYETARIT/NCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE - BASKAN OFISI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014, Kryetari i Komunës së Gjilanit, merrë këtë:

## VENDIM

### PËR

### KOMPENSIMIN E KARTELAVE MBUSHËSE PËR TELEFON CELULAR

1. Bartësit e pozitive t të cilët duhet të pajisen me kartela mbushëse për telefona celularë:

Nr	Zyrtarët	Nr.vl.	Shuma €
1	Asistenti administrativ i kryetarit	2x20	40
2	Roje pylli	12x10	120
3	Shefi i autoparkut	1x10	10
4	Shoferi i kryetarit	1x10	10
5	Ekspeduesi	1x10	10
	Gjithësejt		190


2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ekzekutimi i këtij vendimi duhet nga data 01.02.2018 deri më 31.12.2018

E APPROVUAR  
APPROVED  
ODOBRENO


Kryetari i Komunës  
Lutfi Haziri







REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE**

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

**V E N D I M**  
**PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN PJESË FINANCIARE TE OFERTAVE**  
**Mbështetja e Komunës së Gjilanit në Hartimin e planit**  
**zhvillimor komunal**  
**GL 651 17 024 421**

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Yllka Maloku kryetare e komisionit
2. Ramadan Gashi anëtar i komisionit
3. Jehona Hyseni anëtare e komisionit

**Neni 2**

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

**Neni 2.1**

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

**Neni 2.2**

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

**Neni 2.3**

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

**Neni 2.4**

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

**Neni 3**

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimit të këtij vendimi

**Neni 4**

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

**Gjilan 24/01/2018**

  
Salih Kojku  
Drejtor i Departamentit të Prokurimit




  
Lutfi Haziri  
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIM TË PROJEKTIT  
PËR RREGULLIMIN E KOPSHTIT “ARDHMËRIA II” NË GJILAN**


1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **1252.00 €** (njëmijedyqindesëdhjetedy euro) për subvencionimin e Projektit për rregullimin e kopshtit “Ardhmëria II” në Gjiçan.
2. Mjetet financiare paguhën nga Kodi Buxhetor- Zyra e Kryetarit.
3. Mjetet derdhen në emër të Klubit Rotarian në xhirrollogarinë nr. **1507001004202996** Raiffeisen Bank.
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për subvencionim .
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe të protokollimit të tij.

**Vendimi i dorëzohet:**

- DBF
- Arkiv.




Kryetari i Komunës  
**Lutfi Haziri**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIM TË  
AKTIVITETEVE TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE “GJILANI”**

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **1.480.00€** (njëmijekatërqindetëdhjetë euro) për subvencionimin e aktiviteteve të ansamblit të këngëve dhe valleve “Gjilani”
2. Pagesa e mjeteve financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet nga kodi buxhetor i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Bartja e mjeteve financiare bëhet në xhirrollogarinë e ansamblit nr. **1406000005978524** në Bankën Ekonomike
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për subvencionim.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

- DBF
- Arkiv.





**Kryetari i Komunës**  
**Lutfi Haziri**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIM TË  
AKTIVITETEVE TË SHOQATËS SË ISH TË BURGOSURVE POLITIK DEGA NË  
GJILAN**

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **2.000,00€** (dymijë euro) për subvencionimin e aktiviteteve të shoqatës së ish të burgosurve politik dega në Gjiçan.
2. Mjetet financiare paguhen nga Kodi Buxhetor- Subvencione i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale..
3. Mjetet derdhen në emër të shoqatës në xhirrollogari nr. **1960964873031118 BKT-Kosova** .
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për subvencionim .
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe të protokollimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

- DBF
- Arkiv.




Kryetari i Komunës  
**Lutfi Haziri**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:



VENDIM  
PËR  
RIMBURSIM TË MJETEVE FINANCIARE

1. Me këtë vendim bëhet rimbursimi i mjeteve financiare për z. **Faton Bislimit** nga Gjilani në vlerë prej **2055.45€** (Dymijepesëdhjetepesë euro e dyzetepesë cent).
2. Rimbursimi i mjeteve sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet për mbulimin e shpenzimeve të paguara nga i lartpërmenduri, të ndërlydhura për udhëtimin, dhe pjesëmarrjen në ngjarjen Vip me ish zëvendës Presidentin Amerikan z. Joe Bide në Madison WI me qëllim të dorëzimit të vendimit të kryetarit të Komunës së Gjilanit z. Lutfi Haziri, për shpalljen qytetare nderi të Gjilanit të Beau Biden dhe ftesës për vizitë në Gjilan.
3. Shuma e mjeteve nga pika 1 e këtij vendimi rimbursohet nga mjetet buxhetore – mallra dhe shërbime zyra e Kryetarit të Komunës së Gjilanit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Gjilanit.

Me këtë vendim të njoftohen:  
-DBF dhe,  
- Arkivi Komunal.

Kryetari i Komunës  
**Lutfi Haziri**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 89 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së z. Kushtrim Kadriu 02 nr. 016-6053 të datës 18.01.2018, merr këtë :

### V E N D I M PËR PEZULLIMIN E DAKORDUAR TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

1. Me këtë Vendim, i Lejohet pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës, z. Kushtrim Kadriu i caktuar në pozitën punuese; Bibliotekist në bibliotekën Komunale në Gjiçan në kuadër të Njesisë për Kulturë Rini dhe Sport.
2. Pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet nga data 22.01.2018 deri më datë 21.07.2018 kur i njëjti përfundon të ushroj detyrën e Ekspertit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
3. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar , nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e më pasme ose në një pozitë ekuivalente.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
6. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

#### Vendimi t'i dorëzohet:


- Të emëruarit
- Njesisë së personelit



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri /






ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit veteqeverisjes lokale dhe duke u mbështetur nën 79 pika d) dhe 82.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, kryetari i komunës, merrë këtë :

**V E N D I M**

I. Emërohet komisioni për pranim teknik dhe llogarin përfundimtare të punëve të kryera të projektit :



**Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shillovë e Muhaxherëve, Kmetoc dhe Verbicë e Kmetocit ndarja në Lote 1**

Nr.Prokurimit GI 651 16 051 521:

Komisioni nga pika I. e këtij vendimi ka këtë përbërje :

- |                   |                      |
|-------------------|----------------------|
| 1. Shaqir Ukshini | Kryetar i Komisionit |
| 2. Arjeta Shkodra | anëtare e komisionit |
| 3. Edona Shkodra  | anëtar i komisionit  |

- II. Detyrë e komisionit është të kryej pranimin teknik të punimeve të ekzekutuara nga kompania: " TALI " Sh.p.k nga Gjiçani, në tërësi sipas kontratës për ekzekutimin e punëve dhe të hartojë procesverbal me shkrim në të cilin do të jepë mendim dhe konstatoj se projekti – objekti në fjalë :
- ✓ I përmbushë - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit apo
  - ✓ Nuk i përmbush - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit
- III. Gjatë pranimit teknikë janë të obliguar të marrin pjesë përfaqësuesit e autorizuar të kryesit të punimeve dhe organi mbukqyrës, të cilët do ti japin informatat e nevojshme lidhur me realizimin e punimeve, komisionit për pranimin teknik të projektit .
- IV. Komisioni është i obliguar të përgatis raport me shkrim për punën e vet, i cili duhet t'i prezantohet zyrës së prokurimit dhe zyrës së projekteve.
- V. Komisioni është i obliguar që të fillojë punën menjëher pas pranimit të këtij vendimi, ndërsa ta përfundojë në afatë prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi .

Të i dërgohet :



- arkivës
- zyrës së prokurimit
- zyrës së projekteve
- kryesit të punimeve
- antarëve të komisionit
- mbikqyrësit të punimeve

Më datë: 19.01.2018



Kryetari i Komunës

Stafi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28 e dt; 04 qershor 2008), nenin 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01 nr. 016-126211 të dt; 06.11.2014 dhe legjislacionin përkatës të punës në fuqi pas shqyrtimit të kërkesës së z. Arben Haziri për lejimin e shfrytëzimit të pjesës së mbetur të pushimit vjetor të vitit 2017 nxjerr:

### V E N D I M PËR LEJIMIN E SHFRYTËZIMIT TË PUSHIMIT VJETOR

1. Me këtë vendim, z. Arben Haziri, i emëruar në pozitën; **Asistent administrativ** në Kabinetin e Kryetarit të komunës, **I lejohet** shfrytëzimi i pjesës së mbetur të pushimit vjetor nga viti **2017** në kohëzgjatje prej **10** ditë pune.
2. I emëruari pushimin e lejuar vjetor nga pika **I** e këtij vendimi do ta shfrytëzojë duke filluar prej datës **22.01.2018** e gjer më **02.02.2018** dhe në punë duhet të paraqitet më datë **05.02.2018**.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

#### Vendimi t’i dorëzohet:

- Të emëruarit
- Njesisë së personelit



Kryetari i Komunës

  
/Lutfi Haziri/